




REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT



Nr. .... Prot.

Tiranë, më 19.12.2017

**Vendim**  
**Nr. 36 , datë 19.12.2017**

**PËR SHTIMIN E NJË VEND-ROJE PËR RITJEN E SHËRBIMIT TË  
SIGURISË SË GODINAVE TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Bazuar në nenin 3, pika 3 c,d, 47, 49, pika 1, shkronja **a** të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 90-99 të K.Pr.A si dhe referuar shkresës me nr. 1422/1 Prot, datë 13.11.2017 e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.12.2017

**VËREN SE:**

Me shkresën me nr. 1422/1 Prot, datë 13.11.2017 Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë i është drejtuar Bordit të Administrimit për të kërkuar shtimin e një roje për ritjen e sigurisë së godinave në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë. Më konkretisht, në shkresën e sipërcituar Administratori shprehet se: *"kërkohet shtimi i një vendroje pranë Godinës A, në pjesën lindore të sak, për ritjen e shërbimit të sigurisë së godinave ku zhvillon aktivitetin Universiteti"*. Bashkangjitur kërkesës, Administratori ka vendosur shkresën me nr. 10/08 Prot, datë 10.08.2017, protokolluar pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me nr. 749/25 Prot, datë 10.08.2017 të Administratorit të SHPS-Fizike "STAR-07" Sh.P.K nëpërmjet të cilës parashtrohet se: *"...Gjatë periudhës që ne kryejmë shërbimin pranë këtyre objekteve kemi hasur probleme të shumta, ku njerëz të pandërgjegjshëm kanë tentuar disa herë për ta vjedhur objektin, si dhe të prishin rendin dhe qetësinë publike në ambjentet e mësimdhënies. Nga shërbimet tona disa herë janë shmangur edhe incidente të ndryshme midis studentëve, apo edhe elementëve të tjerë, të cilët përfitojnë nga mos rrethimi i objekteve dhe afrohen deri në hyrjet apo dritaret e sallave të mësimi. Në periudhën Prill-Tetor të çdo viti, shtetas nga komuniteti Rom kanë tentuar të futen disa herë në ambjentet e Universitetit e në afërsi të objektit për tu strehuar, ku na është dashur edhe ndërhyrja e Policisë së Shtetit dhe ajo Bashkiake për ti larguar. Objekte të tilla ku ka grumbullime apo frekuentime masive të shtetasve sot janë edhe në qendër të sulmeve terroriste, ndaj ne si Shoqëri vlerësojmë makimalisht sigurimin e këtyre objekteve"*.



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Për këto arsye Administratori i shoqërisë së sigurimit kërkon që shërbimi të plotësohet me një vendroje 24 orë për të mos lejuar në godinë njerëz që nuk kanë punë.

Bashkangjitur kërkesës së Administratorit është vendosur dhe shkresa me nr. 749/41, datë 08.09.2017 të Specialistëve të shërbimeve nëpërmjet të cilës sqarohet se edhe pse janë hasur vështirësi në ruajtjen e Godinës A dhe Godinës C, ato janë shmangur. Më konkretisht në paragrafin e parë të kësaj shkrese citohet se: *"Rastet problematike të ndodhura në universitet gjatë kryerjes së shërbimit të rojeve na janë bërë me dije nga shoqëria. Gjithësesi ato janë shmangur duke mos krijuar shqetësim të procesit të mësimdhënies dhe mbarëvajtjes së punës së stafit"*. Gjithashtu në këtë shkresë drejtuar Administratorit, bëhet me dijeni se: *"Universiteti është objekt i rëndësishëm në qytet dhe sjellja e shqetësimit nga shoqëria për siguri suplementare në situatat e terrorizmit duhet marrë në konsideratë"*.

Bashkangjitur gjithashtu gjendet shkresa me nr. 1422 Prot, datë 13.11.2017 *"Llogaritja e Fondit Limit për Shërbimin dhe Ruajtjen e sigurisë të Objekteve të Universitetit"*, nëpërmjet të cilës është llogaritur se shuma shtesë në total për këtë shërbim është 13450086.3 lekë. Efekti financiar është 3.445.211 lekë.

Administratori gjithashtu ka paraqitur një relacion nëpërmjet të cilit kërkohet të miratohet shtimi i një vendroje duke argumentuar se: *"Krahu ballor është i mbuluar nga shërbimi sigurisë plotësisht, ndërsa krahu tjetër (pas godinës) bëhet i vështirë për tu mbuluar nga shërbimi aktual i sigurisë, sepse është jashtë rrezes së vrojtimit. Duhet të lihet vendroja për pjesën ballore që të kontrollohet pjesa pas godinës. Lulishtet që rrethojnë godinën frekuentohen nga njerëz të shumtë dhe sidomos gjatë periudhës Prill-Tetor ato okupohen nga komuniteti Rom. Shpesh herë është dashur ndërhyrja e Policisë së Shtetit për të shmangur incidentet apo dëmtimet nga vjedhjet"*.

Për këto arsye është kërkuar miratimi i kërkesës për shtimin e një vendroje shtesë në pjesën lindore të godinës A daljes së emergjencës dhe portës hyrëse të bibliotekës, e cila do të rriste shërbimin e sigurisë së godinës dhe do të shmange dëmtimet nga tentativat për vjedhje.

Bordi i Administrimit pasi bisedoi çështjen në tërësi si dhe shqyrtoi gjithë dokumentacionin e paraqitur, vëren se kërkesa është e pabazuar në ligj dhe në prova dhe për këtë arsye ajo duhet të rrëzohet.

Bordi i Administrimit kontaton se shërbimi i sigurisë realizohet me vendroje të vendosura sipas skemave bashkangjitur dokumentacionit. Deri në momentin që është paraqitur kjo kërkesë, ky sigurim ka funksionuar, fakt që provohet me shkresën me nr. 749/25 Prot, datë 10.08.2017 të Administratorit të SHPS-Fizike "STAR-07" Sh.P.K nëpërmjet të cilës parashtrohet se: *"...Gjatë periudhës që ne kryejmë shërbimin pranë këtyre objekteve kemi hasur probleme të shumta, ku njerëz të pandërgjegjshëm kanë tentuar disa herë për ta vjedhur objektin, si dhe të prishin rendin dhe qetësinë publike"*



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

në ambientet e mësimdhënies. Nga shërbimet tona disa herë janë shmangur edhe incidente të ndryshme midis studentëve, apo edhe elementëve të tjerë, të cilët përfitojnë nga mos rrethimi i objekteve dhe afrohen deri në hyrjet apo dritaret e sallave të mësimi”...

Pra siç argumentohet më sipër, sistemi i sigurimit me tre roje ka funksionuar dhe rojet e shërbimit kanë shmangur incidente të ndryshme. Ky fakt pohohet dhe me shkresën me nr. 749/41, datë 08.09.2017 të Specialistëve të shërbimeve nëpërmjet të cilës pohohet se edhe pse janë hasur vështirësi në ruajtjen e Godinë A dhe Godinës C, ato janë shmangur. Më konkretisht në paragrafin e parë të kësaj shkrese citohet se: “Rastet problematike të ndodhura në universitet gjatë kryerjes së shërbimit të rojeve na janë bërë me dije nga shoqëria. Gjithësesi ato janë shmangur duke mos krijuar shqetësim të procesit të mësimdhënies dhe mbarëvajtjes së punës së stafit”.

Ky fakt është pranuar dhe nga vetë Administratori, i cili ka argumentuar në relacionin shoqëruar se është dashur ndërhyrja e policisë së Shtetit për të shmangur vjedhjet apo incidentet e ndryshme.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, Bordi i Administrimit arrin në përfundimin se duke qenë sistemi me tre roje ka funksionuar, atëherë është e panevojshme që të shtohet dhe një vendroje tjetër. Ky fakt përforcohet dhe nga argumentimi i dhënë në shkresën e shoqërisë së sigurimit nëpërmjet të cilës ajo ka pohuar se kur rastet kanë qenë problematike, ajo i është drejtuar Policisë së Shtetit që e ka për detyrë të ndërhyjë në raste të tilla si dhe Policisë Bashkiake. Pra rezulton plotësisht e provuar se përveç sistemit aktual të sigurisë, ka funksionuar dhe bashkëpunimi institucional midis Policisë së Shtetit dhe policisë private si dhe midis kësaj të fundit dhe Policisë Bashkiake. Në këtë kontekst, Bordi i Administrimit sugjeron që ky bashkëpunim të vazhdojë në mënyrë që incidente të tilla të parandalohen.

Bordi i Administrimit mendon që problemi për ruajtjen e godinave të zgjidhet me mjete alternative siç janë vendosja e kamerave të sigurisë. Bordi ka miratuar buxhetin për vitin 2017, i cili ka patur një zë të veçantë për blerjen e paisjeve elektronike dhe midis tyre edhe kamerave të sigurisë, të cilat janë vendosur në Universitet siç pohohet dhe nga anëtarët e Bordit të zgjedhur nga Universiteti. Pra për rastin konkret është gjetur një zgjidhje e përshtatshme, për survejimin e këtyre ambienteve, të cilat shfaqen si problematike.

Anëtarët e B.A mendojnë se një nga detyrat më të rëndësishme të tij është mirëmenaxhimi i fondeve të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë me qëllim që ato të përdoren në mënyrën e duhur dhe më produktive në funksion të studentëve, të cilët duhen të jenë prioritet i të gjithë organeve të Universitetit përfshirë dhe Bordin e Administrimit. Ky detyrim bëhet më evident në kushtet kur për pak kohë Institucionet Publike të Arsimit të Lartë do të kalojnë në vetëfinancimin e veprimtarisë së tyre.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Përsa i përket shqetësimit se gjatë muajve Prill-Tetor ambjentet e U.V okupohen apo tentohet që të streohen njerëz të komunitetit Rom, Bordi i Administrimit sqaron se veprime të tilla bien në kundërshtim me ligjin penal dhe në këtë mënyrë përbëjnë vepër penale. Nëse nga ana e shoqërisë, ose nga stafi i U.V konstatohen raste të tilla, Bordi i Administrimit sugjeron që këto organe ti drejtohen Policisë së Shtetit, apo dhe prokurorisë duke bërë kallëzim penal në mënyrë që këta persona të mbajnë përgjegjësi për dhunimin e ambjenteve të universitetit apo në rastet e prishjes së qetësisë publike siç pretendohet.

Gjithashtu Bordi i Administrimit me shqetësim vëren se si nga ana e shoqërisë së sigurimit, ashtu dhe nga ana e specialistëve të shërbimeve është shfaqur shqetësimi për mundësinë e rasteve të terrorizmit duke qenë se këto godina frekuentohen nga një numër i lartë njerëzish.

Nëse shoqëria e sigurimit, apo stafi i U.V ka dyshime serioze për sulme të tilla, apo mendon se Universiteti "Ismail Qemali" mund të jetë objekt i këtyre sulmeve, ata duhet të njoftojnë menjëherë Policinë e Shtetit si dhe organet e tjera ligjzbatuese në mënyrë që universitetit ti ofrohet ruajtje nga ana e këtyre organeve.

Nisur nga sa u prashtrua më sipër Bordi i Administrimit, në përfundim

**VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesës së Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për shtimin e një vendroje për rritjen e sigurisë në godinat e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1. Dr. Rezana Vrapit – Kryetar
2. Florian Nurçe – anëtar
3. Enida Pulaj – anëtar
4. Elsajed Rexhaj – anëtar
5. Marinela Muço – anëtar
6. Ornela Koleka - anëtar

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.